



- [Të reja](#) [Kush jemi](#) [Historiku](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet](#) [Video](#) [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#) [Donacione](#) [Policimi në Komunitet](#)
- [Përmbledhja Mujore](#) [Për sinjalizimin](#) [Të Guximshëm pa Armë](#)

Breaking News: Pukë/Finalizohet operacioni i koduar “Gjurmimi”



Lajmet

Operacionet

17/08/2026

Pukë/Finalizohet Operacioni I Koduar “Gjurmimi”

Pukë/Finalizohet operacioni i koduar “Gjurmimi”, si rezultat i hetimeve të kryera për disa javë, me metoda proaktive.

Goditen një rast i kultivimit të bimëve narkotike dhe një rast i armëmbajtjes pa leje.

Arrestohet në flagrancë autori i dyshuar, i cili u kap në flagrancë në vendin ku kishte kultivuar 105 bimë narkotike.

Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë, me një krehër me fishekë, që u gjet në banesën e i tij, si dhe asgjësohen bimët e dyshuara narkotike.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Pukë, si rezultat i hetimeve të kryera me metoda proaktive, për disa javë, për goditjen e një rasti të kultivimit të bimëve narkotike, finalizuan operacionin e koduar “Gjurmimi”. Si rezultat i këtij operacioni u identifikua dhe u arrestua shtetasi:

-T. Ll., 58 vjeç, banues në fshatin Kodërbojë, Pukë.

Ky shtetas u kap në flagrancë në fshatin Kodërbojë, në një parcelë në tokë publike, ku ishin kultivuar 105 bimë të dyshuara narkotike Cannabis Sativa, të cilat u asgjësuan nëpërmjet djegies.

Në vijim, gjatë kontrollit në banesën e 58-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë, me një krehër me municion luftarak.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Shkodrës, për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.



Pukë/Finalizohet operacioni i koduar “Gjurmimi”

Policia e Shtetit



Watch on

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)